



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 239 Prot.

Roskovec, më 01.04 2021

VENDIM

NR 19 .DATË 31.03.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
“PËRMIRËSIMI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM PËR QYTETIN E
ROSKOVECIT”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.2 germa b; ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” nenet 7; 8 germa ç; 9/1; 10 pika 1 germa c; 11; 17 dhe 19; VKM nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar; VKM Nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”; Shkreses nr. 1248/1 prot, datë 02.03.2021 të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnje, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e një ndryshimi në Shpronësimin e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga zbatimi i projektit: “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit” sipas listës bashkëngjitur.
- 2- Miratimin e ndryshimit të vlerës së Shpronësimin të pasurive të sipërcituara me vlerë paraprake si më poshtë:
Ishte:
 - Vlera e tokës arë: 923208 lekë
 - Vlera e kulturës bujqësore: 40984 lekë
 - Totali: 964 192 lekë*Bëhet:*
 - Vlera e tokës arë: 923 208 lekë
 - Vlera e kulturës bujqësore: 48 340.75 lekë
 - Totali: 971 548.75 lekë
- 3- Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga fondi i caktuar në zërin “Shpronësime për interes publik” i planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2021.



- 4- Ngarkohet Komisioni i Shpronësimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

